



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 169, Datë 26.10.2017

MBI

FILLIMIN E PROCEDURËS PËR RISHIKIMIN E “RREGULLORES PËR ORGANIZIMIN FUNKSIONIMIN DHE PROCEDURAT E ERE-S”

Në mbështetje të neneve 16 dhe 110 pika 2 të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike“, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij, të datës 26.10.2017, mbasi shqyrtoi relacionin për rishikimin e “Rregullores për Organizimin Funkzionimin dhe Procedurat e ERE-s“, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016, të përgatitur nga Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit :

Konstatoi se:

Kjo rregullore ka nevojë për përmirësime dhe saktësime në referencë të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” si dhe ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për rishikimin e “Rregullores për Organizimin Funkzionimin dhe Procedurat e ERE-s, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s nr.96, datë 17.06.2016.
2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë të interesuarit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI